DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

RAPORTI VJETOR
ANNUAL REPORT

2020

PËRMBAJTJA
TABLE OF CONTENTS

1. **MESAZH PËRSHËNDETËS I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË DPPI-së 7**
   GREETING MESSAGE FROM THE GENERAL DIRECTOR OF GDIP

2. **HYRJE (PRONËSIA INDUSTRIALE) 11**
   INTRODUCTION (*INDUSTRIAL PROPERTY*)

3. **PROFILI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE 13**
   PROFILE OF THE GENERAL DIRECTORATE OF INDUSTRIAL PROPERTY

4. **ORGANIGRAMA 17**
   ORGANIZATION CHART

5. **SHËRBIMET QË OFRON DPPI 18**
   SERVICES PROVIDED BY GDIP

6. **STRATEGJIA KOMBËTARE E PRONËSISË INTELEKTUALE 2016-2020 .....25**
   NATIONAL INTELLECTUAL PROPERTY STRATEGY 2016-2020

7. **TAKIME NË KUADËR TË HARTIMIT TË STRATEGJISË SË RE 2021-2025 .....41**
   MEETINGS WITHIN THE NEW NATIONAL STRATEGY 2021-2025

8. **VENDIMET E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË DPPI 44**
   DECISIONS OF THE GDIP SUPERVISORY BOARD

9. **REGJISTRIMI I OBJEKTEVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE 48**
   REGISTRATION OF INDUSTRIAL PROPERTY OBJECTS

   SEKTORI I PATENTAVE 48
   PATENT SECTOR

   SEKTORI I EKZAMINIMIT TË MARKAVE TREGTARE DHE TË SHËRBIMIT, DISENJOVE ...53
   INDUSTRIALE, TREGUESVE GJEOGRAFIKË DHE EMËRTIMEVE TË ORIGJINËS
   TRADEMARK AND SERVICE EXAMINATION SECTOR, DESIGNS
   INDUSTRIAL, GEOGRAPHICAL INDICATIONS AND DESIGNATIONS OF ORIGIN

   DISENJOT INDUSTRIALE 62
   INDUSTRIAL DESIGNS

   TREGUESIT GJEOGRAFIKË 64
   GEOGRAPHICAL INDICATIONS

10. **DREJTORIA E KOORDINIMIT, PROMOVIMIT, TRAJNIMEVE DHE ANALIZËS 71**
    DIRECTORATE OF COORDINATION, PROMOTION, TRAINING AND ANALYSIS

    TAKIMET DHE TRAJNIMET E ORGANIZUARA 72
    ORGANIZED MEETINGS AND TRAININGS

TAKIME PUNE NË ZYRAT HOMOLOGE NË ZBATIM TË MARRËVESHJEVE TEKNIKE TË BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E PRONËSISË INDUSTRIALE 77

WORKING MEETINGS IN HOMOLOGICAL OFFICES IMPLEMENTING TECHNICAL COOPERATION AGREEMENTS IN THE FIELD OF INDUSTRIAL PROPERTY

MBLEDHJET E KËSHILLIT MBIKQYRËS 95
MEETINGS OF THE SUPERVISORY COUNCIL

11. MARRËVESHJE BASHKËPUNUMI 98
COOPERATION AGREEMENT

12. ANALIZA E PRONËSISË INTELEKTUALE 105
ANALYSIS OF INTELLECTUAL PROPERTY

TAKIME ME BIZNESIN 106
BUSINESS MEETINGS

TAKIME ME DHOMAT E TREGTISË DHE INDUSTRISË 121
MEETINGS WITH CHAMBERS OF COMMERCE AND INDUSTRY

TAKIME ME UNIVERSITETET DHE DAR 123
MEETINGS WITH UNIVERSITIES AND RED

KONKURSI KOMBËTAR NË FUSHËN E PRONËSISË INDUSTRIALE 129
NATIONAL COMPETITION IN THE FIELD OF INDUSTRIAL PROPERTY

PROJEKTI TWWINING & PROJEKTI ALSIP 131
TWINNING PROJECTS & ALSIP PROJECTS

13. AKTIVITETET 138
ACTIVITIES

14. SEKTORI JURIDIK.....143
LEGAL SECTOR

ÇËSHTJE NË GJYKATË 145
CASE IN COURT

15. RAPORTI FINANCIAR 148
FINANCIAL REPORTS

16. BURIMET NJERËZORE.....152
HUMAN RESOURCES

SHKURTIME
ABBREVIATIONS

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë industriale General Directorate of Industrial Property	**DPPI** GDIP
Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale World Intellectual Property Organisation	**OBPI** WIPO
Pronësia Intelektuale Intellectual Property	**PI** IP
Zyra Evropiane e Patentave European Patents Office	**ZEP** EPO
Zyra e Bashkimit Evropian për Pronësinë Intelektuale European Union Intellectual Property Office	**ZBEPI** EUIPO
Bashkimi Evropian European Union	**BE** EU
Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Technology Transfer Centre	**QTT** TTC
Qendrat e Kërkimit Shkencor Scientific Research Centre	**QKSH** SRC
Republika e Shqipërisë Republic of Albania	**RSH** RoA
Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin United Nations Development Programme	**PKBZH** UNPD
Ministria e Financave dhe Ekonomisë Ministry of Finance and Economy	**(MFE)** (MFE)
Drejtoria për të Drejtën e Autorit dhe të drejtave të lidhura me to Directorate of Copyright and related rights	**(DDA)** (DC)
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme Ministry for Europe and Foreign Affairs	**(MEPJ)** (MEFA)

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

MESAZH PËRSHËNDETËS I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË DPPI

WELCOME MESSAGE FROM THE DIRECTOR GENERAL OF GDIP

I nderuar lexues,

Kam kënaqësinë të ndaj me Ju, përmes publikimit të Raportit Vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, punën dhe veprimtarinë e këtij institucioni gjatë vitit 2020.

Ky raport është një instrument i rëndësishëm transparence dhe llogaridhënie, në të cilin ne synojmë të prezantojmë rezultatet dhe punën tonë gjatë harkut kohor të një viti kalendarik.

Viti 2020 ka qenë një vit i vështirë në mbarë globin duke afektuar jetët e gjithsecilit prej nesh si dhe çdo sektor të shoqërisë njerëzore. Situata e shkaktuar nga pandemia COVID 19, padyshim që ndikoi dhe në performancën dhe përditëshmërinë e veprimtarisë së DPPI-së, por kjo nuk na ndaloi që të arrijmë rezultate të kënaqshme krahasimisht me një vit më parë. Më lejoni të ndaj me ju disa nga arritjet kryesore të institucionit tonë.

U miratuan ndryshimet e projektligjit në Këshillin e Ministrave me VKM nr.1041, datë 16.12.2020, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9947/2008 Për Pronësinë Industriale",* i cili konsiston në përafrimin e direktivës së Sekretit Tregtar, krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Pronësisë Industriale, Sistemi i Administrimit të Pronësisë Industriale (SAPI) si dhe disa ndryshime që janë kërkuar nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut (ISHMT) mbi rregullimin e parimeve të përgjithshme të funksionimit të saj në fushën e PI. Ky projektligj është përcjellë për miratim në Kuvendin e Shqipërisë.

Në kuadër të Strategjisë së Kombëtare të Pronsisë Industriale 2016-2020, si dhe falë politikave të DPPI–së për rritjen e ndërgjegjësimit të palëve të interesuara dhe bizneseve, shënuam 4100 aplikime për markë me një rritje prej 6.8%

Dear reader,

I have the pleasure to share with you, through the publication of the Annual Report of the General Directorate of Industrial Property, the work and activity of this institution during 2020.

This report is an important instrument of transparency and accountability, in which we aim to present the results of our work over the course of a calendar year.

2020 has been a difficult year all over the globe affecting the lives of each of us in every sector of human society. The situation caused by the COVID 19 pandemic undoubtedly affected the performance and daily life of the GDIP activity, but this did not stop us from achieving satisfactory results compared to a year ago. Let me share with you some of the key achievements of our institution.

Amendments to the draft law were approved by the Council of Ministers with DCM no. 1041, dated 16.12.2020, "On some additions and amendments to law 9947/2008 on Industrial Property", which consists in the approximation

krahasuar me vitin 2019 nga të cilat 1164 janë aplikime kombëtare.

Si rezulatat i rritjes së numrit të aplikimeve, DPPI e mbylli vitin 2020 me një rritje prej 13.15 % të të ardhurave i cili përkthehet në shërbime më cilësore ndaj qytetarëve dhe nivele më të larta të performancës.

Prekëm 19 qytete të Republikës së Shqipërisë dhe mbi 100 biznese në kuadër të fushatave ndërgjegjësuese që Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ndërmerr me qëllim informimin e tyre mbi objektet e PI dhe rëndësinë që ato kanë për ti dhënë vlerë biznesit që ato përfaqësojnë.

Një nga arritjet tona më të rëndësishme në vitin 2020 ishte përfshirja në platformën unike qeveritare E-Albania, ku DPPI që nga data 15 Korrik 2020, ofron 154 shërbime online për palët e interesuara.

Në kuadër të angazhimit dhe forcimit të sistemit të pronësisë intelektuale në RSH, prioritet i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale është hartimi i Strategjisë së Re Kombëtarë të Pronësisë Intelektuale 2021-2025, pasi përmbylli me sukses mbledhjen e fundit të strategjisë që lamë pas, duke përmbushur pjesën më të madhe të aktiviteteve dhe objektivave të parashikuara në planin e saj të veprimit. Hartimi i Strategjisë së re është një nismë e DPPI, e para në kuadër të planit të bashkëpunimit që ka me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale prej vitesh dhe së dyti është institucioni koordinues i Kapitullit 7 "*Të drejtat e pronësisë intelektuale"*.

Strategjia e re pritet të miratohet në 6 mujorin e II të vitit 2021, duke përcaktuar qartë angazhimet e secilit institucion i cili është i përfshirë në zinxhirin institutcional të zbatimit të këtyre të drejtave në Republikën e Shqipërisë.

Në zbatim të planit të saj të veprimit, DPPI rëndësi të veçantë i ka kushtuar bashkëpunimeve me partnerët në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e pronësisë industriale me qëllim forcimin e bashkëpunimit në fushën e përgjegjësisë.

of the Directive on the Protection of Trade Secrets, the creation of the basis of State Data on Industrial Property, Industrial Property Management System (SAPI) as well as some changes requested by the State Inspectorate of Market Surveillance (ISMT) on the regulation of the general principles of its operation in the field of IP . This draft law has been submitted to the Albanian Parliament for approval.

In the framework of the National Industrial Property Strategy 2016-2020, thanks to the agenda of GDIP to increase the awareness of stakeholders and businesses, we recorded 4100 applications for the brand with an increase of 6.8% compared to 2019 of which 1164 are national applications.

As a result of the increase in the number of applications, GDIP closed the year 2020 with an increase of 13.15% of revenues which translates into better services to citizens and higher levels of performance.

We visited 19 cities of the Republic of Albania and over 100 businesses in the framework of awareness campaigns that the General Directorate of Industrial Property undertakes in order to inform them about IP facilities and the importance they have to give value to the busi-ness they represent.

One of our most important achievements in 2020 was the inclusion in the unique government platform E-Albania, where GDIP since July 15, 2020, provides 154 online services for stakeholders.

In the context of engaging and strengthening the intellectual property system in the Republic of Albania, the priority of the General Directorate of Industrial Property is the drafting of the New National Intellectual Property Strategy 2021-2025, after successfully concluding the last meeting of the strategy we left behind, meet most of the activities and objectives set out in its action plan. The drafting of the new Strategy is an initiative of GDIP, the first in the framework of the cooperation plan it has with the World

Pikërisht në vitin 2020, pavarësisht vështirësive, arritëm të nëshkruanim 7 marrëveshje bashkëpunimi dhe konkretisht me:

- Organizatën Europiane të Patentave;
- Projekin Shqiptaro-Zvicerian (ALSIP);
- Zyrën e Pronësisë Industriale të Republikës së Çekisë;
- Zyrën e Pronësisë Industriale të Republikes së Finlandës;
- Dhomën Kombëtare të Zejtarisë;
- Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve;
- Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

Me mbështetjen e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale si dhe me përkushtimin dhe profesionalizmin e Prof. Dr. Marjana Semini-Tutulani, botuam për herë të parë në gjuhën shqipe manualin për Gjyqtarë, Prokurorë dhe institucione të tjera ligjzbatuese, *"Mbi hetimin dhe ndjekjen e veprave penale, që lidhen me çështjet e të drejtave të pronësisë intelektuale*".

Një partner i rëndësishëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale mbeten Universitetet dhe Institucionet arsimore. Gjatë vitit 2020, DPPI vizitoi të gjitha Qendrat e Informacionit tekniko – Shkencor të ngritura pranë universiteteve teknike (Tiranë, Shkodër, Vlorë dhe Korçë) për të krijuar një kulturë të drejtë partneriteti midis institucioneve shtetërore, arsimit dhe biznesit në Shqipëri.

Në dhjetor të vitit 2020, DPPI përmbylli me sukses Konkursin Kombëtar "*Të mbrojmë të drejtat e pronësis*ë industriale në Republikën e Shqipërisë". Megjithëse në kushtet e distancimit social, DPPI organizoi konkursin me pjesëmarrjen e 10-të shkollave të mesme të Tiranës. Nxënësve fitues iu akkorduan dhurata të ofruara nga projekti shqiptaro-zvicerian në fushën e pronësisë Intelektuale (ALSIP) si dhe kompania Pepsi. Për të gjithë nxënësit pjesëmarrës u shpërndanë certifikata.

Organization of Intellectual Property for years and the second is the coordinating institution of Chapter 7 "Intellectual Property Rights".

The new strategy is expected to be approved in the second half of 2021, clearly defining the commitments of each institution which is involved in the institutional chain of implementation of these rights in the Republic of Albania.

Pursuant to its action plan, GDIP has paid special attention to cooperation with partners at national and international level in the field of industrial property in order to strengthen cooperation in the field of responsibility.

Exactly in 2020, despite the difficulties, we managed to sign 7 cooperation agreements, specifically with:

- European Patents Office (EPO)
- Albanian-Swiss Intellectual Property Project (ALSIP)
- Industrial Property Office of the Czech Republic
- Industrial Property Office of Finland;
- National Chamber of Crafts;
- National Chamber of Mediators;
- Agency for the Delivery of Integrated Services (ADISA)

With the support of the World Intellectual Property Organization as well as the dedication and professionalism of Prof. Dr. Marjana Semini-Tutulani, we published for the first time in Albanian the manual for Judges, Prosecutors and other law enforcement institutions, "On the investigation and prosecution of criminal offenses related to intellectual property rights issues".

Universities and educational institutions remain an important partner of the General Directorate of Industrial Property. During 2020, GDIP visited all Technical-Scientific Information Centers set up at technical universities (Tirana, Shkodra,

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucioni kryesor përfitues i dy projekteve të rëndësishme në fushën e pronësisë intelektuale. Projekti Shqiptaro-Zvicerian në fushën e pronësisë intelektuale (ALSIP) i cili mbështet nga Qeveria zciceriane dhe do të zgjasë 4 vite si dhe projekti Twinning "*Strengthening the protection and the enforcement of intellectual property rights in the Republic of Albania*", i cili do të zgjasë 1 vit.

Të dy këto projekte do të ofrojnë mbështetje për institucionet e përfshira duke rritur aftësitë e tyre për të mbështetur harmonizimin e plotë të legjislacionit shqiptar me rregullat përkatëse të BE-së në fushën e ligjit dhe politikës së pronësisë intelektuale.

Në përfundim të fjalës sime më lejoni të shpreh falenderimet e mia për të gjitha institucionet partnere, institucionet në nivel kombëtar të përfshira në sistemin e mbrojtjes së pronësisë intelektuale dhe anëtarët e grupit ndër-institucional të punës të kapitullit 7 "Pronësia Intelektuale", përfaqësuesit e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri si dhe partnerët tanë ndërkombëtarë.

Mirënjohje të thellë shpreh për Organizatat Ndërkombëtare të Pronësisë intelektuale, konkretisht Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale, Zyrën Europiane të Patentave dhe Zyrën e Bashkimit Europian për Pronësinë Intelektuale, të cilët kanë dhënë një kontribut të kënaqshëm për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, duke ofruar asistencën e nevojshme teknike si dhe kanë vlerësuar performancën e institucionit tonë në të gjitha arritjet e saj. Gjithashtu, 2 (dy) punonjës të DPPI-së janë të punësuar në EUIPO, duke forcuar në këtë mënyrë marrëdhënien e bashkëpunimit ndërmjet dy zyrave.

Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale është shprehur për punën e DPPI-së:

Znj. Virag Halgand, e cila është përgjegjëse në WIPO për bashkëpunimin me Shqipërinë u shpreh:

Vlora and Korca) to create a fair culture of partnership between state institutions, education and business in Albania.

In December 2020, GDIP successfully concluded the National Competition "To protect industrial property rights in the Republic of Albania". Although in terms of social distance, GDIP organized the competition with the participation of 10 high schools in Tirana. The winning students were awarded gifts offered by the Albanian-Swiss project in the field of Intellectual Property (ALSIP) and the company Pepsi. Certificates were distributed to all participating students.

The General Directorate of Industrial Property is the main beneficiary institution of two important projects in the field of intellectual property. The Albanian-Swiss project in the field of intellectual property (ALSIP) which is supported by the Swiss Government and will last 4 years and the Twinning project "Strengthening the protection and enforcement of intellectual property rights in the Republic of Albania", which will last 1 year.

Both of these projects will provide support to the institutions involved by increasing their capacity to support the full harmonization of Albanian legislation with relevant EU rules in the field of law and intellectual property policy.

At the end of my speech let me express my gratitude to all partner institutions, institutions at the national level involved in the intellectual property protection system and members of the inter-institutional working group of Chapter 7 "Intellectual Property", representatives of The Delegation of the European Union to Albania as well as our international partners.

Expresses deep gratitude to the International Intellectual Property Organizations, namely the World Intellectual Property Organization, the European Patent Office and the European Union Intellectual Property Office, who have made a satisfactory contribution to the Directorate-General for Industrial Property by providing assistance. necessary technical and have evaluated the performance of our institution in all its

*"Ne mirëpresim përpjekjet nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) për të promovuar pronësinë intelektuale si një mjet për rritjen e subjekteve të biznesit dhe zhvillimin ekonomik. Në veçanti, fushata e gjerë e informimit nga DPPI në të gjithë vendin dhe përdorimi i zgjeruar i mediave sociale për të komunikuar me një larmi audiencash do të avancojë për të rritur ndërgjegjësimin mbi rolin kyç të subjekteve të Biznesit të Vogël dhe të Mesëm në ekonomi dhe sesi ata mund të përdorin të drejtat e Pronësisë Industriale për të ndërtuar subjekte biznesi më të forta dhe më konkurruese. Kjo qasje është në përputhje me tematikën, Pronësia Intelektuale dhe SMEs "**Marrja e ideve tuaja për tregun**" në Ditën Botërore të Pronësisë Industriale 2021.*

Zyra Europiane e Patentave është shprehur:

*Bashkëpunimi me Zyrën Europiane të Patentave (EPO) është nënshkruar në vitin 2020. Pas miratimit të Planit Strategjik të EPO (SP2023) në 2019, Drejtoria e P*ërgjithshme e *Pronësisë Industriale (DPPI)* është *përfshirë në mënyrë aktive* në hartimi*n e politikave, si në miratimin e dokumentit të ri të politikës së bashkëpunimit (CA /27/20) në seancën e qershorit të mbledhjes së Këshillit Administrativ. Ngjarje e shënuar ishte nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Drejtorisë së* Përgjithshme *të Pronësisë Industriale (DPPI) dhe Zyrës Evropiane të Patentave, e cila hapi një kapitull të ri në marrëdhëniet midis dy zyrave. Marrëveshja i ofron aplikantëve shqiptar*ë mundësinë për të përfituar nga kërkimi *i cilësisë së lartë të patentave evropiane i kryer nga Zyra Evropiane e Patentave në një kornizë të thjeshtuar administrative me një rregullim të veçantë financiar për bizneset e vogla. Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje nga data 1 Tetor 2021, individët shqiptar, subjektet e biznesit të vogël dhe të madh edhe universitetet shqiptare do të duhet të paguajnë 20% të çmimit të plotë të kërkimit për të marrë Raportin Evropian të Kërkimit.*

Qëllimi i marrëveshjes është të përforcojë inovacionin dhe të kontribuojë në përgjithësi për rritjen e aftësisë konkurruese të ekonomisë shqiptare.

achievements. Also, 2 (two) employees of GDIP are employed in EUIPO, thus strengthening the cooperation relationship between the two offices.

The World Intellectual Property Organization has commented the work of GDIP-së:

Mrs. Virag Halgand, who is responsible in WIPO for cooperation with Albania said:

*"Ne mirëpresim përpjekjet nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (GDIP) për të promovuar pronësinë intelektuale si një mjet për rritjen e subjekteve të biznesit dhe zhvillimin ekonomik. Në veçanti, fushata e gjerë e informimit nga GDIP në të gjithë vendin dhe përdorimi i zgjeruar i mediave sociale për të komunikuar me një larmi audiencash do të avancojë për të rritur ndërgjegjësimin mbi rolin kyç të subjekteve të Biznesit të Vogël dhe të Mesëm në ekonomi dhe sesi ata mund të përdorin të drejtat e Pronësisë Industriale për të ndërtuar subjekte biznesi më të forta dhe më konkurruese. Kjo qasje është në përputhje me tematikën, Pronësia Intelektuale dhe SMEs"**Marrja e ideve tuaja për tregun**" në Ditën Botërore të Pronësisë Industriale 2021.*

The European Patent Office has stated:

Cooperation with the European Patent Office (EPO) was signed in 2020. Following the approval of the EPO Strategic Plan (SP2023) in 2019, the General Directorate of Industrial Property (GDIP) has been actively involved in policy-making, as in the adoption of the new cooperation policy document (CA / 27/20) at the June meeting of the Administrative Council. The highlight of the event was the signing of the Cooperation Agreement between the Directorate-General for Industrial Property (GDIP) and the European Patent Office, which opened a new chapter in the relationship between the two offices. The Agreement offers Albanian applicants the opportunity to benefit from the high quality European patent application conducted by the European Patent Office in a simplified administrative framework with a special financial arrangement for small businesses. Upon entry into force of this Agreement by date 1 October 2021, Albanian individuals, subjects of small and large business

Një falënderim i veçantë i takon stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, të cilët me përkushtim dhe këmbëngulje arritën të përmbushin në kohë të gjitha prioritetet dhe objektivat e vendosura me herët, duke e vlerësuar si mjaft të suksesshme performancën e vitit 2020, për institucionin tonë.

Përzemësisht,

Ledina Beqiraj

Drejtor i Përgjithshëm

also albanian universities will have to pay 20% of the full research price to get the European Research Report.

The purpose of the agreement is to strengthen innovation and to contribute in general to increasing the competitiveness of the Albanian economy.

A special thanks goes to the staff of the General Directorate of Industrial Property, who with dedication and perseverance managed to meet in time all the priorities and objectives set earlier, assessing as quite successful the performance of 2020, for the institution our.

Yours sincerely,

Ledina Beqiraj

Director General

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

HYRJE: PRONËSIA INDUSTRIALE
INTRODUCTION: INDUSTRIAL PROPERTY

Ky raport kryesisht tregon dhe reflekton zbatimin, efektin, perspektivën e standardeve si dhe eficencën e aftësive të të të gjithë stafit si specialistë (profesionistë) në fushën e pronësisë industriale. Raporti bazohet në standardin e aftësive dhe në punën e e palodhshme të kryer gjatë vitit 2020, si një vit i vështirë dhe sfidues..

Raporti Vjetor i DPPI-së shërben si një libër i hapur ose urë komunikimi, për të përhapur njohuri të ndryshme rreth drejtorisë dhe punës voluminoze të saj. Gjithashtu, shërben dhe për zbatimin aktual të ligjit për pronësinë industriale dhe për rritjen e ndërgjegjësimit mbi fushën, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) përcakton në mënyrë të qartë strategjitë dhe objektivat e saj afatshkurtra dhe afatmesme për të prioritizuar drejtimin dhe objektivat strategjikë për realizimin e vizionit të saj.

Ekonomia inovative bazohet në idenë se dija, inovacioni, teknologjia dhe sipërmarrja janë forcat e zhvillimit ekonomik. Në një ekonomi të bazuar në dije, kapaciteti dhe kreativiteti inovativ janë lëndë djegëse për rritjen ekonomike. Të drejtat e pronësisë intelektuale janë mjeti për mbrojtjen ligjore të atyre forcave lëvizëse. Kjo është arsyeja themelore pse vendet duhet të zhvillojnë një sistem të besueshëm dhe të mirëfunksionuar të pronësisë intelektuale.

Ky sistem fuqizon bizneset, industritë dhe individët për të mbrojtur krijimet e tyre inovative intelektuale dhe rezultatet e veprimtarive të tyre kulturore dhe krijuese. Kjo u jep atyre mundësinë të gëzojnë të drejtat e tyre morale dhe të komercializojnë të drejtat e tyre materiale që burojnë nga puna dhe investimet e tyre inovative dhe krijuese. Mundësia për të nxjerrë vlera të përshtatshme ekonomike nga puna dhe investimet e tyre inovative dhe krijuese është

This report mainly shows and reflects the implementation, effect, perspective of the standards as well as the efficiency of the skills of all staff as specialists (professionals) in the field of industrial property. The report is based on the skillful and tireless work done during 2020, a difficult and challenging year.

The GDIP Annual Report serves as an open book or communication bridge, to disseminate various knowledge about the directorate and its voluminous work. It also serves for the current implementation of the law on industrial property and for raising awareness on the field, all over the territory of the Republic of Albania.

The General Directorate of Industrial Property (GDIP) clearly defines its short-term and medium-term strategies and objectives to prioritize the direction and strategic objectives for the realization of its vision.

Innovative economy is based on the idea that knowledge, innovation, technology and entrepreneurship are the forces of economic development. In a knowledge-based economy, innovative capacity and creativity are the fuel for economic growth. Intellectual property rights are the means of legal protection of those driving forces. This is the fundamental reason why countries need to develop a credible and well-functioning system of intellectual property.

This system empowers businesses, industries and individuals to protect their innovative intellectual innovations and the results of their cultural and creative activities. This gives them the opportunity to enjoy their moral rights and commercialize their material rights stemming from their innovative and creative work and investment. The opportunity to derive appropriate economic values from their innovative and creative work and investment is

shumë stimuluese për punën dhe investimet e mëtejshme.

Mjedisi stimulues në të cilin bizneset, industritë dhe individët mund të presin që puna dhe investimi i tyre inovativ dhe krijues të mbrohen dhe do të bien në tokë pjellore varet shumë nga sistemi kombëtar i pronës intelektuale efikase dhe të prosperuar.

Diversiteti i krijimtarisë njerëzore dhe krijimtarisë si dhe konvergjencat e mbrojtjes së tyre ligjore e bëjnë sistemin e pronësisë intelektuale një domosdoshmëri për zbatimin efektiv të rezultateve të veprimtarisë krijuese njerëzore.

Kjo nënvizon domosdoshmërinë e menaxhimit adekuat të tërësisë së krijimit dhe / ose marrjes së rezultateve intelektuale të punës njerëzore dhe përdorimin efektiv të tyre. Sistemi i pronësisë intelektuale globalisht konsiderohet si një nënsistem i rëndësishëm për optimizimin e raportit midis kostos totale dhe përfitimit të përgjithshëm të inovacionit dhe krijimtarisë në të gjitha nivelet nga një kompani individuale, përmes sektorëve industrialë në ekonominë kombëtare dhe globale.

DPPI është e përkushtuar të promovojë një "zhvillim të shëndoshë dhe të qëndrueshëm" në gamën e plotë të aktiviteteve të saj.

Sa më lart përmendur, si dhe me besimin dhe vullnetin e plotë që zhvillimi i sistemit të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë është në drejtimin e duhur, ne do të vazhdojmë të jemi të përkushtuar në avancimin e zhvillimit të bashkëpunimeve dhe negociatave me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit në këtë fushë, për të përmbushur jo vetëm misionin tonë por edhe të ndikojmë në zhvillimin e inovacionit.

very stimulating for further work and investment.

The stimulating environment in which businesses, industries and individuals can expect their innovative and creative work and investment to be protected and fall to fertile ground depends heavily on the national system of efficient and prosperous intellectual property.

The diversity of human creativity and creativity as well as the convergences of their legal protection make the system of intellectual property a necessity for the effective implementation of the results of human creative activity.

This underscores the need for adequate management of the entirety of the creation and / or acquisition of the intellectual results of human labor and their effective use. The intellectual property system is globally regarded as an important subsystem for optimizing the ratio between total cost and overall benefit of innovation and creativity at all levels by an individual company, through industrial sectors in the national and global economy.

GDIP is committed to promoting "healthy and sustainable development" in the full range of its activities.

As mentioned above, with the full confidence and will that the development of the industrial property system in the Republic of Albania is in the right direction, we will continue to be committed to advancing the development of cooperation and negotiations with all actors. and stakeholders in this field, to fulfill not only our mission but also to influence the development of innovation.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

PROFILI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

PROFILE OF GENERAL DIRECORATE OF INDUSTRIAL PROPERTY

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) është institucion publik jo-buxhetor që regjistron, administron dhe promovon objektet e PI-së dhe funksionon si agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ka selinë e vet në Tiranë.

Gjithashtu një rol të rëndësishëm DPPI ka në rritjen e ndërgjegjësimit tek palët e interesuara, aktorët e përfshirë në sistem si dhe në universitetet dhe institucionet arsimore në të gjithë vendin.

STATUSI

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale është institucioni i ngarkuar me ligj për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e objekteve të PI-së, detyrim që i buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. nga ligji organik nr. 9947, dt 07/07/2008 *"Për pronësinë industriale*" i ndryshuar, neni 189, si dhe nga dokumente të shumtë strategjikë si: Marrëveshja e Asociim-Stabilizimit në nenin 73 të saj, "*Pronësia Intelektuale*", Plani Kombëtar Integrimit Europian 2018-2020, etj.

DPPI është institucioni i vetëm nëpërmjet të cilit, shteti shqiptar jep të drejtat mbi patentat mbi shpikjet dhe modelet e përdorimit, topografinë e produkteve gjysmëpërçues, markat tregtare dhe të shërbimit, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë, duke iu njohur mbajtësve të së drej-tave pronësinë mbi këto objekte, nëpërmjet regjistrimit të tyre.

DPPI mban dhe rolin e koordinatorit të Kapitullit VII 'Pronësia Intelektuale', ku raporton gjithashtu në Komitetin e Stabilizim Asociimit dhe në Nënkomitetin e Tregut të Brendshëm dhe Konkurrencës si dhe pranë Delegacionit të Bashkimit Evropian mbi ecurinë dhe aktivitetin e kryer në përmbushje të detyrimeve që na ngarkojnë dokumentet strategjikë.

The General Directorate of Industrial Property (GDIP) is a public non-budgetary institution that registers, administers and promotes IP facilities and operates as an autonomous agency under the supervision of the minister responsible for the economy and is headquartered in Tirana.

GDIP also has an important role in raising awareness among stakeholders, actors involved in the system as well as in universities and educational institutions throughout country.

THE STATUS

The General Directorate of Industrial Property is the institution charged by law for the registration, administration and promotion of IP facilities, an obligation arising from the Constitution of the Republic of Albania. by organic law no. 9947, dated 07/07/2008 "On industrial property" as amended, article 189, as well as from numerous strategic documents such as: Stabilization and Association Agreement in its article 73, "Intellectual Property", National Plan for European Integration 2018- 2020, etc.

GDIP is the only institution through which the Albanian state grants patent rights to inventions and models of use, topography of semiconductor products, trademarks and service marks, industrial designs and geographical indications, recognizing the right holders property of these objects, through their registration.

GDIP also holds the role of coordinator of Chapter VII 'Intellectual Property', where it also reports to the Stabilization and Association Committee and the Subcommittee on Internal Market and Competition as well as to the Delegation of the European Union on the progress and activity carried out in fulfilling our obligations. upload strategic documents.

Pra, DPPI është institucioni koordinues në të gjitha dokumentet e rëndësishme strategjike të palës ndërkombëtare dhe jo vetëm.

MISIONI

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka si mision të forcojë mbrojtjen e pronësisë industriale brenda territorit shqiptar nëpërmjet njohjes, regjistrimit, dhe promovimit të këtyre të drejtave, për të garantuar një nivel mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të Bashkimit Evropian;

- *Fokusi i DPPI-së konsiston në përmirësimin e funksionimit të sistemit të pronësisë industriale me qëllim, nxitjen dhe mbështetjen e inovacionit nëpërmjet nxitjes së punës kërkimore, në veçanti nga kompanitë shqiptare, universitetet vendase dhe individët drejt zhvillimit ekonomik dhe standardeve më të larta. Në mënyrë specifike, do të shërbejë si një mjet për të inkurajuar investimet në kërkim dhe zhvillim, si dhe për të garantuar suksesin në treg.*

- *Mbrojtja e sistemit të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë bazohet në legjislacionin kombëtar si edhe traktatet e konventat ndërkombëtare në të cilat, Republika e Shqipërisë është anëtare.*

OBJEKTIVI

- *Sigurimin e një menaxhimi dhe koordinimi të brendshëm dhe global, për të përmirësuar pronësinë intelektuale, mbrojtjen dhe zbatimin e saj në mbarë botën;*

- *Arritjen e një organizimi ekselent për forcimin e bashkëpunimit në marrëdhëniet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;*

- *DPPI është e angazhuar të përmbushë sfidat për implementimin e arritjeve strategjike, objektivave dhe inicativave të ndërmarra në ''Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020".*

So, GDIP is the coordinating institution in all important strategic documents of the international side and not only.

THE MISSION

The mission of the General Directorate of Industrial Property is to strengthen property protection industrial within the Albanian territory through the recognition, registration, and promotion of these rights, to guarantee a level of protection equal to that of the countries of the European Union;

- *The focus of the GDIP is to improve the functioning of the industrial property system in order to promote and support innovation through the promotion of research work, in particular by Albanian companies, local universities and individuals towards economic development and higher standards. Specifically, it will serve as a tool to encourage investment in research and development, as well as to guarantee market success.*

- *The protection of the industrial property system in the Republic of Albania is based on the national legislation as well as the international treaties and conventions in which the Republic of Albania is a member.*

OBJECTIVES

- *Sigurimin e një menaxhimi dhe koordinimi tëbrendshëm dhe global, për të përmirësuarpronësinë intelektuale, mbrojtjen dhe zbatimine saj në mbarë botën;*

- *Achieving an excellent organization for strengthening cooperation in national and international relations;*

- *GDIP is committed to meeting the challenges of implementing the strategic achievements, objectives and initiatives undertaken in the " National Intellectual Property Strategy 2016-2020".*

ORGANIGRAMA

ORGANIGRAMA-ORGANISATION





SHËRBIMET QË OFRON DPPI
SERVICES PROVIDED BY GDIP

Lloji i shërbimit / Type of Service

PATENTAT PËR SHPIKJET / LICENSE FOR INVENTIONS	
1	**Kërkesë për regjistrimin kombëtar të patentës për shpikje** Application for national patent registration for invention
2	**Kërkesë për regjistrimin kombëtar të patentës për shpikje sipas TBP** Application for national patent registration for invention under TBP
3	**Kërkesë për shtrirje të patentës evropiane** Application for the extension of the European license
4	**Kërkesë për shtrirjen e aplikimit për patentë evropiane** Application for the extension of the European license application
5	**Kërkesë për vlefshmëri të patentës europiane** Application for validity of European license
6	**Kërkesë për vlefshmëri të aplikimit për patentë evropiane** Application for validity of the European license application
7	**Kërkesë për konvertimin e aplikimit për patentë evropiane në aplikim për patentë kombëtare.** Application for conversion of European license application into national license application.
8	**Kërkesë për kthimin e kërkesës për patentë shpikjeje në kërkesë për model përdorimi** Request for the return of an invention license application to a use model application
9	**Kërkesë për dhënien e Certifikatës së Mbrojtjes Shtesë për Produktet Mjekësore dhe Produktet e Mbrojtjes së Bimeve** Request for issuance of Additional Protection Certificate for Medical Products and Plant Protection Products
10	**Kërkesë për apelim në bordin e apelit të refuzimit të certifikatës së mbrojtjes shtesë** Request for appeal to the appellate board of rejection of the supplementary protection certificate
11	**Kërkesë për pavlefshmëri të certifikatës së mbrojtjes shtesë** Request for invalidity of the additional protection certificate
12	**Aplikim për Patentë Europiane** European License Application
13	**Kërkesë për aplikim ndërkombëtar për patentë** Application for an international license application
14	**Kërkesë për kundërshtimin e dhënies të patentës për shpikje** Application for opposition to the grant of a license for an invention
15	**Kërkesë për ripërteritjen e patentës për shpikje** Application for patent renewal for invention.
16	**Kërkesë për publikimin e ndryshimeve në pretendime të patentave evropiane të shtrira ose të Patentave Europiane të validuara.** Request for publication of changes in extended European patent claims or validated European License.
17	**Kërkesë për regjistrimin në regjistër të ndryshimit të emrit te aplikantit/pronarit të patentës për shpikje** Application for registration in the register of change of name of the applicant / owner of the patent for invention
18	**Kërkesë për regjistrimin në regjistër të transferimit të pronësisë, të patentës për shpikje** Application for registration in the register of transfer of property, of the patent for invention
19	**Kërkesë për regjistrimin në regjistër të kontratës së licenses të patentës për shpikje** Application for registration in the register of the patent license contract for invention
20	**Kërkesë për regjistrimin në regjistër të garancisë/pengut për patentën për shpikje** Application for registration in the register of the guarantee / pledge for the patent for invention
21	**Kërkesë për regjistrimin në regjistër të veprimeve përmbarimore për patentën për shpikje** Request for registration in the register of enforcement actions for the patent for invention

22	**Kërkesë për regjistrimin e ndryshimit të adresës së aplikantit/pronarit të Patentës për Shpikje** Request for registration of change of address of the applicant / owner of the Invention Patent
23	**Kërkesë për apelimin e refuzimit të patentës për shpikje në Bordin e Apelimit** Request for an appeal against the denial of a license for an invention to the Board of Appeal
24	**Kërkesë për rivendosjen në afat të patentës** Request for reinstatement of the patent
25	**Kërkesë për ndarjen e aplikimit fillestar për licensë** Request on the separation of the initial license application
26	**Kërkesë për dorëheqje nga aplikimi për patentë** Request for resignation from the license application
27	**Kërkesë për dorëheqje nga aplikimi ose certifikata e mbrojtjes shtesë** Request for resignation from the application or certificate of additional protection.
28	**Kërkesë për publikim të parakohshëm të aplikimit për patentë** Request for early publication of the license application
29	**Kërkesë për shqyrtim të mëtejshëm ose zgjatje afatit të aplikimit për patentë** Request for further review or extension of the license application deadline
30	**Kërkesë për korrigjimin e pasaktësive në të dhënat e patentës** Request for correction of inaccuracies in license data.
	MARKAT TREGTARE / TRADEMARKS
31	**Aplikim për regjistrim kombëtar të markës individuale** Application for national registration of individual trademark
32	**Aplikim për regjistrim kombëtar të markës kolektive ose certifikuese** Application for national registration of a collective or certification mark
33	**Kërkesë për transferimin e aplikimit për regjistrim ndërkombëtar të markës** Request for transfer of application for internationaltrademark registration.
34	**Kërkesë për transferim aplikimi per shtrirje e mëvonshme territoriale të mbrojtjes së Markë Tregtare ndërkombetare** Request for transfer of application for later territorial extension of protection of an international trademark.
35	**Kërkesë për tranformim të regjistrimit ndërkombëtar në aplikim kombëtar** Request for transformation of the international registration into a national application.
36	**Kërkesë për kufizimin e listës së mallrave** Request for restriction of the list of goods
37	**Kërkesë për ndarjen e aplikimit fillestar për regjistrim marke** Request for separation of the initial application for trademark registration
38	**Kërkesë për kundërshtimin e regjistrimit të një marke në dhomën për shqyrtimin e kundërshtimeve** Request for objection to the registration of a trademark in the objection review room
39	**Kërkesë për rivendosjen në afat** Request for reinstatement on time
40	**Kërkesë për zgjatjen e afatit për plotësim dokumentacioni** Request for extension of the deadline for completion of documentation
41	**Kërkesë për shfuqizimin/ zhvlerësimin e një marke në dhomën për shfuqizim /zhvlerësim** Request for revocation / devaluation of a trademark in the revocation / devaluation room.
42	**Kërkesë për apelimin në Bordin e Apelit të vendimeve të marrë nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve dhe nga Dhoma për Shfuqizim /Zhvlerësim** Request for appeal to the Board of Appeals of decisions taken by the Chamber for the Review of Objections and by the Chamber for Repeal / Impairment
43	**Kërkesë për apelim të refuzimit në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim** Request for rejection in the room for revocation / devaluation.
44	**Kërkesë për ripërtëritjen e markës** Request for brand renewal
45	**Kërkesë për regjistrimin në regjistër të transferimit të pronësisë mbi markën** Request for registration in the register of transfer of property over the trademark
46	**Kërkesë për regjistrimin në regjistër të ndryshimit në emër të pronarit të markës** Request for registration in the register of change in the name of the trademark owner

47	**Kërkesë për regjistrimin në regjistër të kontratës së licensës në regjistrin e markave** Request for registration in the register of the license contract in the register of trademarks
48	**Kërkesë për regjistrimin në regjistër të kontratës së pengut në regjistrin e markave** Request for registration in the register of the pledge contract in the register of trademarks
49	**Kërkesë për regjistrimin në regjistër të veprimeve përmbarimore në regjistrin e markave** Request for registration in the register of enforcement actions in the register of trademarks.
50	**Kërkesë për regjistrimin në regjistër të pasqyrimit të ndryshimeve të tjera në regjistrin e markave** Request for registration in the register of reflection of other changes in the register of trademarks
51	**Kërkesë për regjistrimin në regjistrimin në regjistër të ndryshimit në adresë** Request for registration in the register of change of address.
52	**Kërkesë për dorëheqje nga marka e rregjistruar** Request for resignation from the registered trademark.
53	**Kërkesë për saktësimin e të dhënave mbi markën** Request for specification of brand data
54	**Kërkesë për dorëheqje nga aplikimi për markë** Request for resignation from the trademark application.
55	**Kërkesë për observim ndaj markës së publikuar** Request for observation against the published trademark
	MODELE PËRDORIMI / USAGE MODELS
56	**Kërkesë për regjistrimin kombëtar të modelit të përdorimit** Application for national registration of the usage model
57	**Kërkesë për kundërshtimin e dhënies së modelit të përdorimit** Request for opposition to the granting of the usage model
58	**Kërkesë për ripërteritjen e modelit të përdorimit** Request for renewal of the usage model
59	**Kërkesë për regjistrimin e transferimit të pronësisë mbi modelin e përdorimit** Request for registration of transfer of property over the usage model
60	**Kërkesë për regjistrimin e ndryshimit të adresës së aplikantit/pronarit të modelit të përdorimit** Request for registration of change of address of the applicant / owner of the usage model
61	**Kërkesë për regjistrimin në regjistër të ndryshimit të emrit të aplikantit/pronarit të modelit të përdorimit** Request for registration in the register of change of name of the applicant / owner of the usage model
62	**Kërkesë për regjistrimin e kontratës së licensës të modelit të përdorimit** Request for registration of the license model of the usage model
63	**Kërkesë për regjistrimin të garancisë/pengut të modelit të përdorimit** Application for registration of the guarantee / pledge of the usage model
64	**Kërkesë për regjistrimin të veprimit përmbarimor të modelit të përdorimit** Request for registration of the executive action of the use model
65	**Kërkesë për apelimin e refuzimit të modelit të përdorimit në Bordin e Apelimit** Request for appeal against the rejection of the use model to the Board of Appeal
66	**Kërkesë për rivendosjen në afat të modelit të përdorimit** Request for timely restoration of the usage model
67	**Kërkesë për dorëheqje nga aplikimi për modelin e përdorimit** Request for resignation from the application for the usage model
68	**Kërkesë për publikim të parakohshëm të modelit të përdorimit** Request for early publication of the usage model
69	**Kërkesë për shqyrtim të mëtejshëm ose zgjatje afatit të modelit të përdorimit** Request for further review or extension of the usage model
70	**Kërkesë për ndarje të aplikimit për model përdorimi** Kërkesë për ndarje të aplikimit për model përdorimi
Considering the importance of the industrial property for the economic development, the promotion of innovation and the exchange of technology, as well as to strengthen the national systems of industrial property, the parties agreed on broader bilateral cooperation between the Offices.

Both offices agreed to create the necessary modalities before there was a regularexchange of information and good practices, as well as to undertake training and other cooperative activities together.



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

ANALIZA E PRONËSISË INDUSTRIALE

THE ANALYSIS OF INDUSTRIAL PROPERTY

Bazuar në ligjin 9947, datë 7.7.2008 "Për Pronësinë Industriale" i ndryshuar si dhe në "Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020" miratuar me ligjin nr.527 datë 20.07.2016, mbështetur në objektivin nr. IV të saj, një ndër detyrat funkisonale të drejtorisë, është njohja, ndërgjegjësimi dhe promovimi mbi të drejtat e pronësisë industriale. Për realizimin e këtij indikatori Sektori i Promovimit dhe Qendra e Trajnimeve zhvillon aktivitete dhe trajnime me institucionet mbështetëse të PI-së.

Situata e pazakontë e pandemisë Covid-19 që përfshiu globin solli mjaft ndryshime sociale-ekonomike duke kushtëzuar në këtë mënyrë çdo aktivitet social-kulturor.

Gjatë periudhës së dytë të vitit 2020, pavarësisht situatës së jashtëzakonshme të krijuar si pasojë e përhapjes së pandemisë Covid-19, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale rinisi turin e takimeve informuese me biznesin për tu shtrirë gjeografikisht në qytetet kryesore të vendit sipas një kalendari të caktuar.

Turet e vazhdueshme me bizneset kanë funksion informues, ndërgjegjësues dhe promovues lidhur me përfitimet ekonomike dhe juridike që sjell regjistrimi i markave tregtare dhe të shërbimit, disenjove industriale, treguesve gjeografik si dhe shpikjeve dhe modeleve të përdorimit.

Gjithashtu, synohet bashkëpunimi me biznesin vendas, me qëllim rritjen e numërit të bizneseve që regjistrojnë objektet e tyre të pronësisë industriale. Një tjetër synim që Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka është promovimi i produkteve "Made in Albania".

Institucioni ynë është i gatshëm të ofrojë asistencën e nevojshme për të gjithë bizneset vendase jo vetëm në informim dhe ndërgjegjësim por edhe në asistencë per aplikimet e procedurave të regjistrimit çdo objekt të PI-së.

Gjatë vitit 2020 DPPI- ka vizituar 19 qytete nëpër takime informuese-ndërgjegjësuese pranë bizneseve në qytetet kryesorë të vendit. Konkretisht:

Based on law 9947, date 7.7.2008 "For Industrial Property" amended as well as in the "National Intellectual Property Strategy 2016-2020" adopted by law No.527 date 20.07.2016, based on target No. of Its IV, one of the functional duties of the directorate, is recognition, awareness and promotion on industrial property rights. For the realization of this indigator The Promotion Sector and the Training Centre develops activities and training with PI support institutions.

The unusual situation of the Covid-19 pandemic that encircled the globe brought about a lot of social-economic change, thereby affect any social-cultural activity.

During the second period of 2020, despite the extraordinary situation created as a result of the spread of the Covid-19 pandemic, the Directorate-General of Industrial Property resumed the round of informing meetings with business to extend geographically to the country's major cities according to a given calendar.

Continuous business routes have informative, conscientious and promotional functions regarding the economic and legal benefits of registering trade and service brands, industrial disciples, geographical indicators as well as inventions and patterns usage.

Co-operation with local business is also aimed at increasing the number of businesses registering their industrial property objects. Another goal that the Directorate-General of Industrial Property has is to promote "Made in Albania" products.

Our institution is willing to provide the necessary assistance to all local businesses not only in information and awareness but also in assistance with the applications of registration procedures for any PI object.

During 2020 GDIP- visited 19 cities through informing- awareness meetings near businesses in the country's major cities. Concretely:

TAKIME ME BIZNESET NË QYTETIN E PËRMETIT 25-27 SHKURT 2020

BUSINESS MEETINGS IN THE CITY OF PERMET, DATED 25-27 FEBRUARY 2020



TAKIME ME BIZNESET NË QYTETIN E VLORËS 02-04 KORRIK 2020

BUSINESS MEETINGS IN THE CITY OF VLORA 02-04 JULY 2020

TAKIM ME BIZNESET NË QYTETIN E LEZHËS 09-10 KORIIK 2020

BUSINESS MEETINGS IN THE CITY OF LEZHA 09-10 JULY 2020

TAKIME ME BIZNESET NË QYTETIN E BERATIT 16-18 KORRIK 2020

BUSINESS MEETINGS IN THE CITY OF BERAT 16- 18 JULY 2020

TAKIME ME BIZNESIN NË QYTETIN E TROPOJËS 20-22 KORRIK 2020

BUSINESS MEETINGS IN THE CITY OF TROPOJA 20-22 JULY 2020

TAKIM ME BIZNESET NE QYTETIN E HIMARËS 27-29 KORRIK 2020

BUSINESS MEETINGS IN THE CITY OF HIMARA 27-29 JULY 2020

TAKIM ME BIZNESET NË QYTETIN E SARANDËS 03-05 GUSHT 2020

BUSINESS MEETINGS IN THE CITY OF SARANDA 03-05 AUGUST 2020

TAKIME ME BIZNESET NË QYTETIN E MIRDITËS 27-29 GUSHT 2020

BUSINESS MEETINGS IN THE CITY OF MIRDITA 27-29 AUGUST 2020



TAKIME ME BIZNESIN NË QYTETIN E LESKOVIKUT 02-04 SHTATOR 2020

BUSINESS MEETINGS IN THE CITY OF LESKOVIK 02-04 SEPTEMBER 2020

TAKIME ME BIZNESET NË QYTETIN E POGRADECIT 9-11 SHTATOR 2020

BUSINESS MEETINGS IN THE CITY OF POGRADEC 9-11 SEPTEMBER 2020

TAKIME ME BIZNESIN NË QYTETIN E GJIROKASTRËS 14-16 SHTATOR 2020

BUSINESS MEETINGS IN THE CITY OF GJIROKASTRA 14-16 SEPTEMBER 2020



TAKIME ME BIZNESIN NË QYTETIN E DIBRËS 21-23 SHTATOR 2020

BUSINESS MEETINGS IN THE CITY OF DIBRA 21-23 SEPTEMBER 2020

TAKIME ME BIZNESIN NË QYTETIN E KORÇËS 28-30 SHTATOR 2020

BUSINESS MEETINGS IN THE CITY OF KORÇA 28-30 SEPTEMBER 2020

TAKIM ME BIZNESET NË QYTETIN E TEPELENËS 05-07 TETOR 2020

BUSINESS MEETINGS IN THE CITY OF TEPELENA 05-07 OCTOBER 2020

TAKIM ME BIZNESET NË QYTETIN E KUKËSIT 12-14 TETOR 2020

BUSINESS MEETINGS IN THE CITY OF KUKES 12-14 OCTOBER 2020

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit që DPPI ka me Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) gjatë takimeve të zhvilluara pranë biznesseve vendase përfaqësues të DPPI-së kanë zhvilluar takime informuese pranë këtij institucioni. Kryesisht pranë qendrës Kombëtare të Biznesit në qytetin e Tropojës, Sarandës, Pogradecit, Gjirokastrës, Korçës, Tepelenës.

In implementation of the co-operation agreement between the GDIP and the National Business Centre (NRC) during meetings held at local businesses representatives of the GDIP have held informing meetings near this institution. Mainly at the National Business Centre in the city of Tropoja, Saranda, Pogradec, Gjirokastras, Korçës, Tepelena.



QKB





TAKIME ME DHOMAT E TREGTISË DHE INDUSTRISË DHE DREJTORITË RAJONALE DOGANORE

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve strategjike përfaqësues të DPPI-së gjatë takimeve pranë bizneseve kanë organizuar takime ndërinstitucionale dhe me Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë kryesisht të qytetit të Lezhës, Beratit dhe Vlorës.

Qëllimi i këtyre takimeve është bashkërendimi i punës në lidhje më mbrojten e objekteve të Pi-së.

Drejtori i Përgjithshëm i DPPI, Znj. Beqiraj, dhe përfaqësues të institucionit gjatë turit në qytetin e Vlorës zhvilluan një takim me drejtorin e Drejtorisë Rajonale Doganore të Vlorës, Z. Kosta Vjero, si institucion kyç në zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë.

MEETINGS WITH CHAMBERS OF COMMERCE AND INDUSTRY AND REGIONAL CUSTOMS DIRECTORATES

Within the framework of meeting the strategic obligations representatives of the GDIP during meetings with businesses have organised inter-institutional meetings also with the Chambers of Commerce and Industry mainly of the city of Kumanovo, and Vlora.

The purpose of these meetings is to co-ordinate work in relation to protecting PI's objects.

GDIP Director-General Ms. Bejaj and representatives of the institution during the tour of the city of Vlora held a meeting with the director of the Vlora Regional Customs Directorate, Mr Kosta Vjero, as a key institution in implementing industrial property rights in the Republic of Albania.

DHOMA E TREGTISE DHE INDUSTRISE
THE CHAMBER OF COMMERCE AND INDUSTRY
QARKU LEZHE-ALBANIA
DHTI
LEZHE ALBANIA

DHOMA E TREGETISE DHE INDUSTRISE
VLORE

TAKIME NË UNIVERSITETE DHE DREJTORITË RAJONALE ARSIMORE

Një ndër objektivat e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale është informimi dhe ndërgjegjësimi i brezave te rinj lidhur mbi fushën e Pronësisë Industriale. Në kuadër dhe të marrëveshjeve të bashkëpunimit që DPPI ka nënshkruar me Universitetin e Korçës, Shkodrës, Tiranës dhe Vlorës pranë tyre funksionojnë Qendrat e Informacionit Tekniko-Shkencor, si një detyrim i parashikuar në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intektuale 2016-2020. Përfaqësues të Drejtorisë pavarsisht situatës së krijuar nga pandemia, realizuan takime informuese me dy nga universitetet konkretisht atë të Korçës dhe të Shkodrës.

Gjatë takimit të zhvilluar pranë Universiteteve, përfaqësues të DPPI theksuan rëndësinë e fuqizimit të qendrave të informimit dhe ofrimit të trajnimeve për studentët kryesisht në fushën e patentave për shpikje.

Angazhimi i DPPI-së është tregues i vëmendjes që kemi ndaj brezave të rinj, për të nxitur zhvillimin në fushën e shkencës dhe teknologjisë dhe inkurajimit në punën shkencore.

Institucioni ynë shpreh gadishmërinë e plotë t'iu gjendet pranë studenteve nëpërmjet informimit, ndërgjegjësimit dhe ofrimit të mundësisë së praktikave pranë Drejtorisë sonë.

MEETINGS WITH UNIVERSITIES AND REGIONAL EDUCATIONAL DIRECTORATES

One of the objectives of the General Directorate of Industrial Property is to inform and raise awareness of new generations related to the field of Industrial Property. Within the framework and co-operation agreements that the GDIP has signed with the University of Korca, Kumanovo, Tirana and Vlora near them function the Technical-Scientific Information Centres, as an obligation envisaged in the National Strategy of Intektual Property 2016-2020. Representatives of the Directorate regardless of the situation created by the pandemic, held informing meetings with two of the universities in the same way that of Korca and Kumanovo.

During the meeting held at the Universities, GDIP representatives stressed the importance of empowering information centres and providing training for students mainly in the field of patents for invention.

The GDIP's commitment is indicative of the attention we have on younger generations, to promote development in the field of science and technology and encouragement in scientific work.

Our institution expresses its full readiness to be found with students through the information, awareness and provision of the possibility of practices near our Directorate.

Takime në Universitetin “Fan Noli” Korçë

Meetings at “Fan Noli” university of Korçë

Takime në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër

Meetings at the University “Luigj Gurakuqi” Shkodra

TAKIME NDËR-INSTITUCIONALE ME DREJTORITË RAJONALE ARSIMORE

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale në vazhdimësinë e takimeve ndër-institucionale gjatë periudhës së dytë të vitit 2020 nën respektimin e protokollit të sigurisë së pandemisë Covid-19, ka zhvilluar takime me Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar të qyteteit të Korçës dhe Lezhës. Qëllimi i takimeve ishte vendosja e urave të bashkëpunimit si dhe gjetja e formave dhe modaliteteve të nevojshme në lidhje me trajnimin e mësuesve dhe të nxënësve në fushën e pronësisë industriale.

Fokusi i diskutimeve u përqëndrua mbi metodat dhe mënyrën e organizimit të këtyre trajnimeve duke siguruar një përfshirje sa më të gjerë të Zyrave Vendore Arsimore. Drejtoritë rajonale të këtyre qyteteve shprehën mbështetjen dhe gadishmërinë e tyre të bashkëpunimit për të vazhduar lidhur me programet trajnuese që DPPI ofron.

DPPI me nismën e ndërmarrë synon ndërgjegjësimin dhe informimin e stafeve petagogjike dhe brezave të rinj lidhur me objektet e PI-së si dhe rëndësinë që ka promovimi i këtyre të drejtave.

Eksperienca botërore ka treguar që edukimi i brezave të rinj me çështjet dhe konceptet e të drejtave të pronësisë intelektuale është një shembull pozitiv dhe shumë i qëndrueshëm në luftën ndaj piraterisë dhe shkeljeve të drejtave në një shtet të caktuar.

INTER-INSTITUTIONAL MEETINGS WITH REGIONAL EDUCATIONAL DIRECTORATES

The Directorate General of Industrial Property in the continuation of inter-institutional meetings during the second period of 2020 under compliance with the Covid Pandemic Security Protocol- 19, held meetings with the Regional Directorates of Pre-University Education of the city of Korca and Kumanovo. The purpose of the meetings was to establish co-operation bridges as well as to find the necessary forms and modalities in relation to the training of teachers and students in the field of industrial property.

The focus of the discussions focused on the methods and manner of organising these trainings by ensuring as broad an involvement as possible of the Local Education Offices. The regional directorates of these cities expressed their support and readiness for co-operation to continue in terms of the training programmes that the GDIP offers.

The GDIP with the initiative undertaken aims to raise awareness and inform petagogic relays and new generations regarding PI objects, as well as the importance of promoting these rights.

World experience has shown that educating younger generations with issues and concepts of intellectual property rights is a positive and very stable example in the fight against piracy and rights violations in a given state.

DAR Korçë

RED Korçë

Takime me DAR Lezhë

Meetings with RED Lezha

DITA BOTËRORE E PRONËSISË INTELEKTUALE

Për shkak të situatës së krijuar nga Covid -19 Drejtori i Përgjithshëm dha një video mesazh përshëndetës në kuadër të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale si dhe disa intervista në Televizone Kombëtare.

Në 26 Prill të çdo viti Shqipëria, ashtu si dhe vendet e tjera të botës, feston Ditën Botërore të Pronësisë Intelektuale, për të promovuar rëndësinë e saj në inkurajimin e shpikjeve dhe krijimtarisë së mendjes njerëzore.

Në vitin 2000, shtetet anëtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) caktuan 26 prill (datë, në të cilën Konventa për themelimin e WIPO-s hyri në fuqi në vitin 1970), si Ditën Botërore të Pronësisë Intelektuale, me qëllim rritjen e të kuptuarit të përgjithshëm të pronësisë intelektuale.

Dita Botërore e Pronësisë Intelektuale ka ofruar një mundësi unike çdo vit për t'u bashkuar me të tjerët rreth globit për të marrë në konsideratë se si Pronësia Intelektuale (PI) kontribuon në lulëzimin e muzikës dhe arteve dhe udhëheq drejt risive dhe shpikjeve teknologjike që ndihmon ti japim formë botës tonë.

Për vitin 2020 Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO), zgjodhi të kujtojë me sloganin: "*Inovacion për një të ardhme të gjelbër*" me qasjen, se një sistem pronësie intelektuale i ekuilibruar dhe i fortë mund të mbështesë shfaqjen e një ekonomie të gjelbër që funksionon me sisteme të mbështetjes së jetës në tokë duke bërë së bashku të gjitha shtetet anëtare të kujtojnë këtë ditë.

Shpeshherë kërkesat për investime në projekte madhore zhvillimi, veçanërisht në infrastrukturë dhe urbanizim bien ndesh me domosdoshmërinë e ruajtjes së mjedisit, sidomos në kushtet e ndryshimeve klimatike.

Edhe pse teknologjia në tërësi po evoluon dita – ditës, sistemi i patentave po nxit inovacionin, zhvillimin e shpërndarjen e teknologjive "eco-

THE INTERNATIONAL DAY OF INTELLECTUAL PROPERTY

Due to the situation created by Covid -19 The Director General gave a video message welcoming the framework of World Intellectual Property Day as well as several interviews on National Televizone.

On 26 April of each year Albania, as well as other countries of the world, celebrates World Intellectual Property Day, to promote its importance in encouraging the inventions and creativity of the human mind.

In 2000, member states of the World Intellectual Property Organization (WIPO) designated April 26 (the date, at which the Convention for the Founding of WIPO came into force in 1970), as World Intellectual Property Day, with the aim of increasing the overall understanding of intellectual property.

World Intellectual Property Day has offered a unique opportunity every year to join others around the globe to consider how Intellectual Property (PI) contributes to the flourishing of music and the arts and leads towards technological innovations and innovations that help shape our world.

For 2020, the World Intellectual Property Organization (WIPO) chose to recall with the slogan: "Innovation for a green future" with the approach, that a balanced and strong intellectual property system can support the emergence of a green economy that operates with life support systems on earth by making all member states remember this day together.

Often the requirements for investment in major development projects, especially in infrastructure and urbanization, are met with the necessity of preserving the environment, especially in the conditions of climate change.

Although technology as a whole is evolving day by day, the patent system is promoting innovation, development and distribution of eco-friendly technologies, which enable us to build a

friendly", të cilat na mundësojnë të ndërtojmë një të ardhme të gjelbërt pa e dëmtuar mjedisin ku jetojmë. Inovacioni ofron mundësi dhe është çelësi për zhbllokimin e zgjidhjeve dhe qasjeve që na duhen për të krijuar një të ardhme të qëndrueshme dhe të gjelbër.

Angazhimi ynë, zgjedhjet që bëjmë çdo ditë, produktet që blejmë, hulumtimet që ne i financojmë, kompanitë që mbështesim, politikat dhe ligjet që zhvillojmë, janë përcaktuese se sa e gjelbër është e ardhmja jonë.

Me mendimin inovativ dhe përdorimin strategjik të të drejtave të Pronësisë Intelektuale në tërësi, qëndrueshmëria është e mundshme për një mjedis më të gjelbër.

Mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale është tashmë një sistem i mirë organizuar, i cili i sjell dobi të madhe shoqërisë të çdo vendi, si dhe ndikon drejtpërsëdrejti në zhvillimin ekonomik, social e kulturor të tij, ku sot në mbarë botën po i kushtohet një vëmendje tepër e veçantë.

green future without damaging the environment we live in. Innovation offers opportunities and is key to unlocking the solutions and approaches we need to create a sustainable and green future.

Our commitment, the choices we make every day, the products we buy, the research we fund, the companies we support, the policies and laws we develop, are determined how green our future is.

With innovative thinking and strategic use of Intellectual Property rights as a whole, sustainability is possible for a greener environment.

The protection of intellectual property rights is already a good organised system, which greatly benefits the society of each country, as well as directly affects its economic, social and cultural development, where today a very special attention is being paid to the world.

KONKURSI "TË MBROJMË TË DREJTAT E PRONËSISË INDUSTRIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"ME PJESËMARRJEN E ZV. MINISTRIT TË FINANCAVE DHE EKONOMISË

"Të mbrojmë të drejtat e Pronësisë Industriale në Republikën e Shqipërisë" ishte slogani i konkursit të këtij viti që Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale organizoi me gjimnazet e qytetit të Tiranës. Sistemi parauniversitar i Tiranës ka qenë për disa vite i përfshirë në trajnimet e ofruara nga stafi i DPPI-së, në përfundim të së cilave organizohej një konkurs mbi njohuritë e përfituara.

Këtë vit nisur nga pamundësia që na krijoi situata e pandemisë, në zbatim të masave të protokollit të sigurisë COVID-19, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale propozoi zhvillimin e një konkursi on line. Nxënësit mbështetur në njohuritë e marra gjatë ciklit mësimor si dhe materialeve promocionale që DPPI u vuri në dispozicion u ftuan të prezantojnë krijimet e tyre kryesisht (krijimtari dhe inovacion) mbi objektet e pronësisë industriale.

Konkursi u zhvillua nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale në bashkëpunim dhe me mbështetjen financiare të projektit Shqiptaro-Zvicerian ALSIP, të cilët dhuruan për çmimet e para fituese, laptop dhe tabletë si dhe mbështetjen e kompanisë Agna Group & Pepsi që ofroi kuponë blerjesh për tre fituesit.

Ceremonia e ndarjes së çmimeve u mbajt pranë ambjenteve të DPPI duke respektuar masat e vendosura nga protokolli Covid-19.

Pjesë e aktivitetit ishin nxënës të shkollave:

→ Arben Broci,
→ Sinan Tafaj,
→ Partizani,
→ Harry Fultz
→ Sadik Stavileci
→ Turgut Ozal.

Shkolla fituese e vendit të parë për punimin më të mirë u shpall Kolegji Turgut Ozal.

THE COMPETITION "TO PROTECT THE INDUSTRIAL PROPERTY RIGHTS IN THE REPUBLIC OF ALBANIA" WITH THE PARTICIPATION OF THE DEPUTY MINISTER OF FINANCE AND ECONOMY

"Protecting Industrial Property Rights in the Republic of Albania" was the slogan of this year's competition that the Directorate General of Industrial Property organised with tirana city high school. Tirana's pre-graduate system has been involved for several years in training offered by GDIP staff, at the end of which a competition on knowledge was organised.

This year, initiated by the impossibility that created the pandemic situation, in the implementation of the COVID-19 security protocol measures, the Directorate General of Industrial Property proposed the development of an online competition. Students based on knowledge received during the teaching cycle as well as promotional materials that GDIP made available were invited to present their creations mainly (creativity and innovation) on objects of industrial property.

The competition was held by the Directorate General of Industrial Property in co-operation and financial support of the Albanian-Zvicerian ALSIP project, which donated to the first winning awards, laptop and tables, as well as the support of the Company Agna Group & Pepsi which offered the purchase cup for the three winners.

The award-sharing ceremony was held near the GDIP environments, respecting the measures put in place by the Covid-19 protocol.

Part of the activity were schoolstudents:

→ Arben Broci,
→ Sinan Tafaj,
→ Partizani,
→ Harry Fultz
→ Sadik Stavileci
→ Turgut Ozal.

The winning school of the first place for best work was declared The Ozal Turgut College.

Ky konkurs vjen si aktivitet i parashikuar edhe në Strategjinë Kombëtare e Pronësisë Intelektuale (2016-2020) dhe përveç natyrës së tij informuese dhe ndërgjegjësuese, ka si qëllim edhe edukimin e brezit të ri.

This competition also comes as a projected activity in the National Intellectual Property Strategy (2016-2020) and in addition to its informing and conscientious nature, it is also aimed at educating the younger generation.

PROJEKTI TWINNING "STRENGTHENING THE PROTECTION AND THE ENFORCEMENT OF INTELLECTUAL PROPERTY RIGHTS IN THE REPUBLIC OF ALBANIA"

Projekti synon të ofrojë mbështetje për institucionet e përfshira në projekt kryesisht në fushat e mëposhtme:

- Të rrisin aftësitë e tyre për të mbështetur harmonizimin e plotë të legjislacionit shqiptar me rregullat përkatëse të BE-së në fushën e ligjit dhe politikës së pronësisë intelektuale;

TWINING PROJECT "STRENGTHENING THE PROTECTION AND THE ENFORCEMENT OF INTELLECTUAL PROPERTY RIGHTS IN THE REPUBLIC OF ALBANIA"

The project aims to provide support to institutions involved in the project mainly in the following areas:

- Increase their skills to support the full harmonisation of Albanian legislation with relevant EU rules in the field of law and intellectual property policy;

- Të prezantojë modelin e aplikuar të menaxhimit të PI në nivelin Evropian dhe për planifikimin dhe kryerjen e aktiviteteve me qëllim promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit përmes publikut për çështjet e PI, dhe veprimet e krijimit të kapaciteteve për të përgatitur negociatat e pranimit dhe për të adresuar rekomandimet e përcaktuara nga Raporti i Progresit për Shqipërinë nga Komisioni Evropian, veçanërisht kapitulli 7 – Pronësia intelektuale.
- Të ndihmojë ISHMT në ndryshimin ose krijimin e një akti nënligjor të pronësisë industriale, për të kufizuar problemet e hasura në inspektimet në tregun e brendshëm.
- Të ndihmojë ISHMT në hartimin e ndryshimeve të nën-akteve ligjore të nevojshme për zbatimin e Ligjit për Pronësinë Industriale për të pasqyruar përcaktimin ligjor dhe ndarjen midis shkeljes së të drejtave të pronësisë industriale dhe falsifikimit të mallrave;
- Të ndihmojë në hartimin e dispozitave specifike që sqarojnë procedurën administrative dhe procedurën penale.

Shqipëria në veçanti duhet të:

- intensifikojë përpjekjet për të harmonizuar legjislacionin e saj mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat fqinje me acquis të BE-së;
- Përmirësimi i mëtejshëm i funksionimit të agjencive të menaxhimit kolektiv dhe pagesa e honorareve për mbajtësit e të drejtave.

Kuadri ligjor i Republikës së Shqipërisë siguron mbrojtjen e pronësisë intelektuale që përafrohet gjerësisht me acquis commu-nautaire, duke përmbushur një nga anga-zhimet e nenit 73 të Marrëveshjes së Sta-bilizim / Asociimit (MSA) dhe Kapitullit 7 të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian" Të drejtat e pronësisë intelektuale".

Dokumenti i Partneritetit Evropian tregon nevojën për të vazhduar forcimin e autoriteteve përkatëse të Tregut të Brendshëm, duke harmonizuar plotësisht legjislacionin e brendshëm me kërkesat e BE-së dhe MSA-së dhe të sigurojë zbatimin e tij nga të gjitha autoritetet përkatëse.

- Introduce the applied MODEL of PI management at European level and for planning and carrying out activities with the aim of promoting and raising awareness through the public on PI issues, and capacity-building actions to prepare accession negotiations and address recommendations set out by the Progress Report for Albania by the European Commission, especially chapter 7 – Intellectual property.
- Help ISHMT change or create a sublegal act of industrial property, to limit the problems encountered in inspections in the internal market
- Help the ISHMT draft changes to the legal sub-acts necessary for the implementation of the Industrial Property Act to reflect the legal definition and division between violation of industrial property rights and counterfeiting of goods;
- Help draft specific provisions that clarify administrative procedure and criminal procedure.

Albania in particular must:

• intensify efforts to harmonise its legislation on copyright and rights adjacent to the EU acquis;

• Further improving the functioning of collective management agencies and paying honors to rights holders.

The legal framework of the Republic of Albania provides for intellectual property protection that is widely approached by acquis communautaire, fulfilling one of the commitments of Article 73 of the Stabilisation/Association Agreement (MSA) and Chapter 7 of the National Plan for European Integration" Intellectual Property Rights.

The European Partnership document shows the need to continue strengthening the relevant Internal Market authorities, fully harmonising internal legislation with eu and MSA requirements and ensuring its implementation by all relevant

Ai përmend qartë nevojën për të garantuar kapacitete të mjaftueshme administrative për të përmbushur kërkesat e MSA-së në fushën e pronësisë intelektuale dhe industriale.

Në këtë drejtim, neni 39 i marrëveshjes së përkohshme (neni 73 i MSA-së) përcakton që Shqipëria të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar, jo më vonë se katër vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, një nivel të mbrojtjes së të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të ngjashme me ato ekzistuese në BE, duke përfshirë mjetet efektive për zbatimin e të drejtave të tilla.

Takime pune në kuadër të Projektit Twinning "Strengthening the Protection and the Enforcement of Intellectual Property Rights in the Republic of Albania"

- Është zhvilluar mbledhja e parë e Steering Committee e Projektit *Twinning "Strengthening the Protection and the Enforcement of Intellectual Property Rights in the Republic of Albania",* nën drejtimin e liderit të projektit nga pala shqiptare (shteti përfitues), Drejtori i Përgjithshëm i DPPI znj. Ledina Beqiraj dhe Lideri i projektit nga pala greke (shteti anëtar) znj. Dionysia Kallinikou ku u diskutua mbi ecurinë e projektit dhe miratimin e planit fillestar të punës për vitin 2021.

Përfitues të këtij projekti, bazuar në rekomandimet e Komisionit Europian të lëna për kapitullin 7 – Pronësia Intelektuale, janë Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, Drejtoria për të Drejtën e Autorit/Ministria e Kulturës dhe Inspektorati Shtetëror I Mbikqyrjes së Tregut (ISHMT).

authorities. He clearly mentions the need to guarantee sufficient administrative capacities to meet MSA requirements in the field of intellectual and industrial property.

In this regard, Article 39 of the Provisional Agreement (ARTICLE 73 of the MSA) stipulates that Albania take all necessary measures to guarantee, no later than four years after the date of entry into force of this Agreement, a level of protection of intellectual, industrial and commercial property rights similar to those existing in the EU, including effective means for the implementation of such rights.

Working meetings within the Twinning Project "Strengthening the Protection and the Establishment of Intellectual Property Rights in the Republic of Albania"

| The first Meeting of the Steering Committee of the Twining Project "Strengthening the Protection and the Establishment of Intellectual Property Rights in the Republic of Albania" was held, under the direction of the project leader from the Albanian side (beneficiary state), GDIP Director General Mrs. Ledina Beraj and Project Leader from the Greek side (member state) Mrs. Dionysia Kalliniku where it was discussed on the performance of the project and the adoption of the original work plan for 2021.

The beneficiaries of this project, based on the recommendations of the European Commission left for Chapter 7 – Intellectual Property, are the Directorate General of Industrial Property, the Directorate for Copyright/Ministry of Culture and the State Inspectorate of Market Monitoring (ISHMT).



- Drejtori i Përgjithshëm i Pronësisë Industriale, Znj. Ledina Beqiraj, në cilësinë e Project Manager, të projektit Twinning, "Strengthening the Intellectual Property Rights in Republic of Albania" zhvilloi një mbledhje online me shefin Operacional të Delegacionit të Bashkimit Europian në Tiranë z. Enzo Damiani. Të pranishme në takim dhe dy RTA (Resident Twinning Advisor) znj. Krystallenia Kotolorou dhe znj. Rudina Bollano.

Gjatë takimit u diskutua mbi gjendjen aktuale të fillimit të projektit dhe ecuria e tij deri në fund të vitit 2020, e cila do të paraprihet me mbledhjen e Steering Committee, e cila u mbajt më datë 10 dhjetor 2020. Kohëzgjatja e projektit është 1 vit dhe përbëhet nga 3 komponentë kryesorë.

- Director General of Industrial Property, Ms. Ledina Beqiraj, in the quality of Project Manager, of the Twinning project, "Strengthening the Intellectual Property Rights in Republic of Albania" held an online meeting with the Chief Operational Of the European Union Delegation in Tirana, Mr. Enzo Damiani. Present at the meeting and two RTAs (Resident Twinning Advisor) Mrs. Krystallenia Kotolorou and Mrs. Rudina Bollano.

During the meeting it was discussed on the current state of the beginning of the project and its performance by the end of 2020, which will be preceded by the meeting of the Steering Committee, which was held on 10 December 2020. The duration of the project is 1 year and consists of 3 main components.



Drejtori i Përgjithshëm i DPPI, Znj. Ledina Beqiraj, priti në një takim pune, znj. Krystallenia Kolotourou, në cilësinë e Këshilltares së Përhershme të Projektit Twinning, AL 17 IPA FI 01 20, duke u shprehur besimplotë për zbatimin me efektivitet të projektit.

DPPI në këtë projekt është përfituesi kryesor por dhe koordinon punën me institucionet e tjera, të cilat janë përfituese dhe të përfshira në këtë proces konkretisht Ministria e Kulturës, Drejtoria për të Drejtën e Autorit si dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut.

Projekti zgjat 12 muaj dhe do të fokusohet kryesisht në forcimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në Republikën e Shqipërisë.

Konsorciumi zbatues i këtij projekti është Greqi – Itali, duke ofruar ekspertizën e tyre profesionale në këtë fushë për vendin tonë.

The Director General of the GDIP, Ms Ledina Beraj, waited at a working meeting, Mrs. Krystallenia Kolotourou, in the quality of Permanent Advisor to the Twining Project, AL 17 IPA FI 01 20, expressing confidence in the effective implementation of the project.

The GDIP in this project is the main beneficiary but coordinates work with other institutions, which are beneficial and involved in this process, the Ministry of Culture, the Directorate for Copyright and the State Inspectorate of Market Monitoring.

The project lasts 12 months and will focus mainly on strengthening intellectual property rights in the Republic of Albania.

The implementing consortium of this project is Greece–Italy, providing their professional expertise in this area for our country.

PROJEKTI I PRONËSISË INTELEKTUALE SHQIPTARO-ZVICERANE (ALSIP)

Projekti ka si objektiv të japë kontributin e tij ndaj sipërmarrësve, krijuesve, studiuesve dhe prodhuesve në Shqipëri në mënyrë që këta të fundit të përfitojnë nga mbrojtja efektive e objekteve PI.

Historiku dhe konteksti i projektit

Në pak më pak se dy dekada, Shqipëria ka përparuar mjaft ekonomikisht dhe ka ligjëruar pronësinë industriale, të drejtën e autorit, disenjot industriale dhe qarqet e integruara. Ajo po bëhet anëtare e më shumë konventave dhe traktateve ndërkombëtare të pronës intelektuale dhe ka marrëveshje të ndryshme të tregtisë së lirë në të gjithë rajonin. Për të përshpejtuar këtë, reformat strukturore kërkojnë të rrisin produktivitetin dhe konkurrencën, të krijojnë më shumë vende pune dhe të përmirësojnë qeverisjen dhe ofrimin e shërbimeve publike.

Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale të Shqipërisë përcakton se sistemi PI duhet të jetë ai që "siguron mbrojtje efektive të objekteve PI, inkurajon krijimtarinë dhe inovacionin në shërbim të stimulimit të rritjes ekonomike dhe zhvillimit kulturor dhe shkencor në Republikën e Shqipërisë"

Sfidat ndaj sistemit që mbeten shqetësim ndër të tjera janë nevoja për të zhvilluar dhe zbatuar më tej Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale, parandaluar dhe luftuar piraterinë e

ALBANIAN-SWISS INTELLECTUAL PROPERTY PROJECT (ALSIP)

The project aims to make its contribution to entrepreneurs, creators, scholars and producers in Albania so that the latter can benefit from the effective protection of PI objects.

The history and context of the project

In just less than two decades, Albania has progressed significantly economically and has legalized industrial property, copyright, industrial dissension and integrated circles. It is becoming a member of more international intellectual property conventions and treaties and has various free trade agreements throughout the region. To accelerate this, structural reforms seek to increase productivity and competition, create more jobs and improve governance and provision of public services.

Albania's National Intellectual Property Strategy stipulates that the PI system should be the one that "ensures effective protection of PI objects, encourages creativity and innovation in the service of stimulating economic growth and cultural and scientific development in the Republic of Albania".

Challenges to the system that remain concern among others are the need to further develop and implement the National Intellectual Property Strategy, prevent and combat high piracy and continued falsifications, increase awareness of

lartë dhe falsifikimet e vazhdueshme, rritjen e ndërgjegjësimit për PI-të si dhe forcimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të subjekteve të specializuara PI.

Projekti mbështet zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve Shqiptare PI për të konsoliduar kushtet kornizë të përmirësuara për bizneset, konkurrencën e tyre dhe në përgjithësi për sistemet e tregut.

- Legjislacioni i përmirësuar i PI-së dhe zbatimi efektiv i Strategjisë Kombëtare të PI-së kontribuojnë në kushte më të mira të punës për investime dhe inovacione.
- Subjektet e regjistrimit dhe administrimit të RPI-ve që funksionojnë mirë ofrojnë shërbime efikase dhe miqësore me përdoruesit.
- Subjektet e DPI-së, përfaqësuesve privatë dhe akademikë janë përmirësuar në promovimin e blerjes, përdorimit dhe transferimit të DPI-ve tek përdoruesit e mundshëm.
- Zbatimi i RPI-ve është forcuar.
- Ndërgjegjësimi për rëndësinë e komercializimit të KTT dhe RPI si pjesë e procesit të inovacionit është rritur.

PIs as well as strengthen and build the capacities of specialized PI subjects.

The project supports the development of the capacities of Albanian PI institutions to consolidate improved framework conditions for businesses, their competition and in general for market systems.

- Improved PI legislation and effective implementation of the National PI Strategy contribute to better working conditions for investment and innovation.
- Well-functioning RPIs registration and management subjects offer efficient and user-friendly services.
- DPI subjects, private representatives and academics have improved in promoting the purchase, use and transfer of DPIs to potential users.
- The implementation of RPIs has been strengthened.
- Awareness of the importance of commercializing KTT and RPI as part of the innovation process has increased.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

AKTIVITETET
ACTIVITIES

Projekti ofron **këshilla të specializuara dhe mbështetje në zonat e zgjedhura**, në nivele të ndryshme ku Zvicra është e aftë të ofrojë ekspertizë të fortë dhe të zhvillojë aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit, të sigurojë informacionin dhe përvojën përkatëse, dhe së fundmi të ndërtojë kapacitetet e sistemit PI dhe të individëve.

Në **nivelin e politikave**, projekti mbështet rishikimin dhe zbatimin e **Strategjisë Kombëtare të PI-së (2021-2025)**, në mënyrë që institucionet e RPI-së dhe përdoruesit e RPI-së në mesin e popullatës shqiptare të jenë më të aftë të përfitojnë nga mundësitë që ofron sistemi PI. Këtu, projekti mbështet **rishikimin dhe përgatitjen e legjislacionit të ri për PI**.

Ndërtimi i kapaciteteve teknike përmes trajnimeve, workshop-eve dhe **shkëmbimit të përvojave** midis homologëve zviceranë dhe shqiptarë, programeve edukative dhe kontributit të ekspertëve, synojnë ngritjen e cilësisë së regjistrimit të PI-së dhe shërbimeve të administratës të DPPI-së dhe Drejtorisë së të Drejtave të Autorit. Paralelisht, përmes **programeve të informimit** dhe moduleve të trajnimit, projekti mbështet promovimin, përdorimin dhe blerjen e RPI nga grupe specifike të synuara, për të rritur përdorimin dhe komercializimin e RPI, për shembull përmes **shërbimeve të transferimit të njohurive dhe teknologjisë**.

Në fushën kundër falsifikimit, mbahen trajnime dhe vihen në dispozicion burime të dobishme informacioni për të lehtësuar procedurat operacionale dhe për të lehtësuar më tej gjyqësorin, doganat, mbikëqyrësit e tregut dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit për PI-të në rolet e tyre. **Fushatat publike edukative dhe shkëmbimet e përvojave kundra falsifikimit** janë krijuar gjithashtu për të sensibilizuar publikun në përgjithësi kundër piraterisë dhe falsifikimeve.

The project offers specialized advice and support in selected areas, at various levels where Switzerland is capable of providing strong expertise and developing awareness-raising activities, providing relevant information and experience, and recently building the capabilities of the PI system and individuals.

At the policy level, the project supports the revision and implementation of the National PI Strategy (2021-2025), so that RPI institutions and RPI users among the Albanian population are better able to benefit from the opportunities offered by the PI system. Here, the project supports the revision and preparation of new PI legislation.

Building technical capacities through training, workshops and the exchange of experiences between Swiss and Albanian counterparts, educational programmes and expert contribution, aim at raising the quality of PI registration and the services of the GDIP administration and the Directorate of Copyright. In parallel, through information programs and training modules, the project supports the promotion, use and acquisition of RPI by specific target groups, to increase the use and commercialization of RPI, for example through knowledge tran-sfer and technology services.

In the field of anti-counterfeiting, training is maintained and useful sources of information are made available to facilitate operational procedures and further facilitate the judiciary, customs, market super-visors and other law enforcement agencies for PIs in their roles. Public educational campai-gns and exchanges of experiences against counterfeiting have also been created to raise public awareness in general against piracy and counterfeiting.

Së fundmi, si një zhvillim socio-ekonomik dhe mjet i marketingut, promovimi i ndërgjegjësimit rreth **Treguesve Gjeografikë (TG)** dhe potenciali i TG-ve shqiptare do të zhvillohet për të krijuar një inventar TG.

PËRAFRIMI ME PËRPARËSITË E ZHVILLIMIT TË SHQIPËRISË

Projekti PPISHZ është në përputhje me përparësitë kryesore të **zhvillimit socio-ekonomik të Qeverisë së Shqipërisë**. Projekti PPISHZ mbështet Shqipërinë në zbatimin e vizionit të mirë artikuluar në strategjinë e saj Kombëtare të PI-së përsa i përket një sistemi PI, në veçanti për të siguruar regjistrim efektiv dhe mbrojtje të objekteve PI. Kjo mund të inkurajojë krijimtarinë dhe inovacionin për të stimuluar rritjen ekonomike dhe zhvillimin kulturor dhe shkencor në vend.

PËRFITUESIT

Homologët kryesorë të projektit janë Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) dhe Drejtoria e të Drejtave të Autorit (DDA). Përfitues të mëtejshëm përfshijnë aktorë të tjerë të interesuar të sistemit kombëtar të PI-së si: **Policia e Shtetit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Shkolla e Magjistraturës, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Kulturës, Organizatat e Administrimit Kolektiv (OAK), Bashkimi i Dhomave të Tregtisë, Universitetet, konsulentët e PI-së (avokatët e PI-së, konsulentët e transferimit të teknologjisë); dhe shoqatat e zgjedhura të prodhuesve të TG**.

Në veçanti, kompanitë shqiptare, universitetet lokale dhe individët mund të përfitojnë sidomos edhe nga një sistem i përmirësuar i funksionimit të PI-së drejt nxitjes së inovacionit. Po kështu, konsumatorët janë edhe më të mbrojtur nga falsifikimet përmes zhvillimit të kapaciteteve të gjyqësorit dhe agjencive të zbatimit.

Recently, as a socio-economic development and marketing tool, the promotion of awareness about Geographical Indicators (TG) and the potential of Albanian TGs will develop to create a TG inventory.

APPROXIMATION OF ALBANIA'S DEVELOPMENT PRIORITIES

The PPISHZ project is in line with the main socio-economic development priorities of the Government of Albania. The PPISHZ project supports Albania in implementing good vision articulated in its National PI strategy in terms of an PI system, in particular to ensure effective registration and protection of PI objects. This can encourage creativity and innovation to stimulate economic growth and cultural and scientific development in the country.

BENEFICIARIES

The main counterparts of the project are the Directorate General of Industrial Property (GDIP) and the Directorate of Copyright (DDA). Further beneficiaries include other interested actors of the national PI system such as: State Police, State Inspectorate of Market Supervision (ISHMT), General Directorate of Customs, School of Magistrates, Ministry of Agriculture and Rural Development, Ministry of Culture, Collective Management Organizations (OAK), Union of Chambers of Commerce, Universities, PI consultants (PI lawyers, technology transfer consultants); and the selected associations of TG producers.

